

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeparlamentari i Iranit: Epoka e përgjigjeve proporcionale ndaj sulmeve amerikane ka marrë fund
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/kryeparlamentari-i-iranit-epoka-e-pergjigjeve-proporcionale-ndaj-eve-am-1584303
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 13:32:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 14:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b591338f9fe068407beb09382730dbd85fddf07ac8c342846c562cce6bf0b0d6
TEKSTI	d9ed82ae381b93e6c76aad97bd264be9189cdf007b8a43b18be5bb2a60aa15ea
PAMJA	5679272622569872380ef34c468444d12a63277c117c784c4cb30011ae152c45

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b119312ead6a217ab434257c50e264be7f6c267ed0cfe808905366c8b8aa6061
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b153b854c154dd4d6c3613e7c633ddb6afc042e1cebe995d4321c2de8150c895
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b119312ead6a217ab434257c50e264be7f6c267ed0cfe808905366c8b8aa6061>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



IE "Pushteti eshte nje katshe e perbindshme" - Rama per Ilir Meten: E tuti nen vete dhe e katandisi ne personazh qesharakGermani/ Senati refuzoi te paguante shantazhin fundit

Kryeparlamentari i Iranit: Epoka e përgjigjeve proporcionale ndaj sulmeve amerikane ka marrë fund



6 Shtator 2026, 16:15Bota TEMA



Kryetari i Parlamentit të Iranit, Mohammad Baqer Galibaf, ka paralajmëruar se Irani do t'u përgjigjet më fuqishëm çdo sulmi të mëtejshëm ndaj interesave dhe sigurisë së tij, duke thënë se epoka e "përgjigjeve proporcionale" ka marrë fund.

Duke folur gjatë një seance të hapur parlamentare më 6 shtator, Galibaf tha: "Çdo agresion ndaj interesave dhe sigurisë së Iranit do të marrë një përgjigje më të shpejtë, më të fuqishme dhe më të dhimbshme".

Galibaf foli një ditë pasi ushtria amerikane tha se kishte goditur dhe shkatërruar tri cisterna iraniane të naftës pranë ishujve Harg dhe Jask, si dhe në Gjirin e Omanit.

Komanda Qendrore e ushtrisë së SHBA-së (CENTCOM) tha se sulmet erdhën si përgjigje ndaj sulmeve me raketa balistike të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) ndaj dy anijeve luftarake amerikane, sulme nga të cilat nuk pati viktima amerikane.

Komandanti i CENTCOM-it, Brad Cooper, paralajmëroi se sulmet e vazhdueshme iraniane ndaj anijeve amerikane do të përballen me kosto më të mëdha ekonomike dhe shkatërrimin e cisternave iraniane të naftës.

Ministria e Jashtme e Iranit i dënoi sulmet amerikane si "të paligjshme dhe agresive", ndërsa një zëdhënës i Shtabit Qendror Khatam al-Anbiya – komanda qendrore ushtarake e Iranit – paralajmëroi se sulmet ndaj ushtrisë amerikane mund të intensifikohen dhe zgjerohen nëse vazhdon bllokada detare.

Më herët gjatë 6 shtatorit, IRGC-ja pretendoi se sulmoi një dron detar amerikane që po përpiqej të hynte në Ngushticën e Hormuzit.

Ngushtica e Hormuzit është rrugë kyç për dërgesat detare pasi para se të niste lufta në fund të shkurtit, nëpër këtë rrugë ujore kalonte rreth një e pesta e dërgesave botërore të naftës dhe gazit./ REL



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gjermani/ Senati refuzoi të paguante shantazhin 2 milionë euro, hakerët publikojnë 1.4 milionë dosje sekrete, mes tyre plane për sulme bërthamore](#)

15:15 Bota

Dokumenti i BE-së: Rusia dërgoi fëmijë ukrainas të rrëmbyer në një kamp në Korenë e Veriut

14:45 Bota / 1 koment

"Rezik për një tjetër Irak ose Afganistan" - Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes: Trump e ka futur veten në një ngërç, SHBA duhet të ndryshojë strategji për ta fituar luftën

14:35 Bota

"Dekolonizim" apo censurë? Qyteti rusishtfolës i Odesës përgatit kufizime të reja ndaj gjuhës ruse në art dhe kulturë

13:35 Bota / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.